



**"RUAJENI TOKËN,
SEPSE AJO ËSHTE
NËNA E JUAJ..!"**



**PËRSOSJA E MORALIT
SIPAS KËSHILLAVE
TË PROFETIT (A.S)**



**STINA E DIMRIT
DHE BESIMTARI**

Viti 16 - Nr. 12 (190),
Dhjetor, 2018

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

*E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative*

NUK KA ASNJË VLERË TEK ZOTI, asnjë mur i vdekur, para një komuniteti, QË DUHET MËKUAR ME FRYMËN E PAQES DHE HARMONISË!

"...prijësit fetarë, duke ruajtur kufijtë e misionit të shenjtë të udhëzimit të njeriut, si dhe duke u bërë përhapës të së mirës dhe harmonisë, larg fanatizmit të verbër, larg mendësive të dominimit a përçmimit të tjetrit, kushdo qoftë ai, larg tendencave që krijojnë cytje të panevojshme, veprimi i të cilave hedh poshtë krejt punën e mirë të ndërtuar me përkushtim e shembull qytetërues!"



Alhambra, Granada - Spanjë



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

“RUAJENI TOKËN, SEPSE AJO ËSHTË NËNA E JUAJ..!”

i ke ofruar atyre? Dije? Apo fëmijë të pjekur, që pas studimeve u bënë mjekë, gjyqtarë, juristë, inxhinierë, që kryen misionin e tyre më përpikmëri dhe me krejt aftësitë e tyre!

Pra, kur ti thua: Unë do bëj diçka, (duke i dhënë hakun e plotë asaj gjëje), ti je musliman i vërtetë, ndërsa nëse krejt angazhimi dhe përkujdesja jote do të jenë vetëm për interesin tënd personal, vetëm për shtëpinë tënde, duke mos të interesuar asgjë nga hallet e të tjerëve, dije se tek All-llahu, ti nuk ke asnjë peshë!

Duhet të kuptosh fenë si një dhunti, që të nxit drejt përsosmërisë së punës tënde, studimeve tua...”.²

Me fjalë të tjera, Kur’ani na nxit ta trashëgojmë Tokën, duke dhënë më të mirën tonë për të ndërtuar vlera e dobi për jetën mbi të! Në këtë kontekst, të gjithë jemi të përfshirë në këtë Thirrje të shenjtë, në veçanti prijësit fetarë dhe pushtetarët e përkohshëm.

Të parët, pra, prijësit fetarë, duke ruajtur kufijtë e misionit të shenjtë të udhëzimit të njeriut, si dhe duke u bërë përhapës të së mirës dhe harmonisë, larg fanatizmit të verbër, larg mendësive të dominimit a përçmimit të tjetrit, kushdo qoftë ai, larg tendencave që krijojnë ctyje të panevojshme, veprimi i të cilave hedh poshtë krejt punën e mirë të ndërtuar me përkushtim e shembull qytetëruës!

All-llahu i Madhëruar na udhëzon në Kur’anin Famëlartë: “Ne e kemi shënuar në Zebur (në librat e shenjtë) pas shënimit (në Leuhi Mahfudh), se me të vërtetë tokën do ta trashëgojnë robtë e Mi të mirë”.¹

E kam menduar shpesh domethënien dhe përmbajtjen e kuptimeve të këtij ajeti të shenjtë, ku janë përfshirë krejt Librat e shenjtë, Toka, trashëgimia e saj dhe njerëzit e mirë.

Pas disa leximeve dhe kërkimeve, u ndala tek njëri prej komenteve më elitare të kohës, autori i të cilave, prof. dr. Muhammed Ratib En-Nabulsi thotë: “Nga ky ajet kuptojmë se, trashëgimi i ndërtimit të tokës nga të mirët, është prej vërtetësive të përhershme, si dhe prej parimeve absolute të shkruara më herët në Librat e shenjtë; në Kur’an, në Teurat, në Inxhil, a në Zebur.

Që do të thotë: Njerëzit e mirë në administrimin e saj, të mirët në shfrytëzimin e pasurive të saj, të mirët në garantimin e shërbimeve për popullin! Prandaj, pyete veten çdo ditë: Çfarë ke bërë për popullin tënd? Çfarë

Përderisa nuk i zgjidhim problemet e të rinjve; me ligje të qarta dhe të mbara për arsimin e lartë, krijimin e mundësive për zhvillimin e arsimit në kushte bashkëkohore, zgjidhjen përfundimtare

2. Dr. Muhammed Ratib En-Nabulsi (jeton në Aman të Jordanisë), Tefsirun-Nabulsi, botimi i parë, 2016, Aman, Muessetul-Fursan, vëll. 5, f. 512-513.

të problemeve të banimit, krijimin dhe hapjen e mundësive të punësimit, lehtësimin e rrugëve për krijimin e familjeve të reja, miratimin e ligjeve të prera kundër abortit selektiv, por jo vetëm, përpjekjes së vazhdueshme për eliminimin e papunësisë, për shfrytëzimin e pasurive me të cilat na begatuar Zoti; “nuk do të nderohemi në botë, as do të nderohet feja e jonë dhe, kjo është një e vërtetë e hidhur”³, që duhet ta themi me të madhe, duke iu bashkuar krejt zërave të qytetëruar që me dinjitet kërkojnë ndryshimin e të keqes së përhapur në masë dhe heqjen e barrave mbytëse, të padrejta dhe krejtësisht korruptive nga jeta e shqiptarëve, për të cilat kemi tërhequr vëmendjen prej vitesh nëpërmjet predikimeve, thirrjeve të shumta dhe këshillimeve komunitare, në kontekstet e hakut të shtëpisë sonë të përbashkët, Tokës dhe jetës me dinjitet mbi të!

Prandaj, kur njeriut i paqtohet zemra dhe i piqet mendja, kur i rriten ndjenjat dhe i ndizet arsyeja, i ekuilibrohet mendja dhe zemra; kështu ai bëhet i mundur për të qenë mëkëmbës i Zotit mbi Tokë!⁴

TË DASHUR TË PRANISHËM,

Janë të shumta ajetet kur’anore dhe porosinë udhëzuese të Hz. Muhammedit (a.s.), që na ftojnë të kujdesemi për Tokën dhe gjallërimin e saj, me përkushtim e përlujë para bekimeve të Zotit-Krijues!

Në Kur’anin Famëlartë lexojmë: “Ai (All-llahu) është që krijoi kopshte me bimë të ngritura lart, por edhe të rrafshëta, të shtrira në tokë, edhe hurmet dhe drithërat me frute plot shije të ndryshme; (krijoi) ullinjë dhe shegët e ngjashme (nga forma) e jo të ngjashme (nga shija). Hani frutat e tyre kur të piqen dhe ditën e korrjes (e të vjeljes) së frutave jepeni atë pjesë që është obligim (të varfërve e nevojtarëve) dhe (hani-jepni) mos e teproni, sepse Ai nuk i do shpërdoruesit”.⁵

“Ndërsa përkujdesja për pemët dhe specifikimi i kësaj përkujdesjeje në

3. Dr. Muhammed Ratib En-Nabulsi, vepr., e cit., vëll. 5, f. 513.

4. Po aty, vëll. 5, f. 513.

5. Kur’ani, El-En’am: 141.

hadithet e të Dërguarit të All-llahut, është e panumërt, aq sa kushdo që mediton në interesimin e të të Dërguarit të All-llahut për pemët dhe kthimin e vendeve arabe dhe atyre islame në lulishta plot me pemë e gjelbërim; kupton dhe bindet se Islami është fé..., që i ka kushtuar një vëmendje të madhe mbjelljes në përgjithësi dhe interesimit për pemët në veçanti!”⁶

Hz. Muhammedi (a.s.) udhëzoi: “Kushdo që e ngjall një tokë të vdekur, ai është i denjë për të dhe çdo krijesë që ushqehet prej saj, do t’i regjistrohet atij si shpërblim!”⁷ Poashtu na porositi: “Nëse do të bëhet kijameti, ndërkohë që në dorën e ndonjërit prej jush ka një fidan, le ta mbjellë atë!”⁸

PËR FUND TË KËSAJ TRAJTESE,

Një person hyri në bahçen e Hz. Osmanit (r.a.), prijësit të besimtarëve, të cilin e gjeti duke mbjellë ca bimë. I tha: O prijës i besimtarëve, a po mbjell tokën, ndërkohë që është afuar kijameti? Osmani i urtë ia ktheu: “Të më vijë kijameti duke më gjetur prej mirëbërësve, është më e mirë dhe më e dashur për mua sesa, të më vijë e të më gjejë prej keqbërësve!”⁹

Si jo, kur zotëria i tij i përkiste shkollës së madhe të edukimit me përkujdesjen për Tokën dhe përhapjen e të mirës mbi të; Hz. Muhammedit (a.s.), që para 15 shekujsh udhëzoi njerëzinë me fjalën e tij të artë: “Ruajeni Tokën, sepse ajo është Nëna e juaj! Kushdo që do të punojë një të mirë a një të keqe mbi të, ajo do të dëshmojë për të!”¹⁰

Shkodrën dhe trojet tona shqiptare i ka bekuar Zoti me pasuri dhe bukuri natyrore, me tokë pjellore dhe ujë të rrjedhshëm! Të punojmë me krejt mundësitë tona për t’ia kthyer me mirënjohje Zotit këtë bekim të madh, me përgjegjësinë e ruajtjes, përkujdesjes dhe shfrytëzimit të qytetëruar të kësaj mirësie të pallogaritur!

(Fjala e mbajtur në konferencën ndërfaqetare me temë:

“Të mbrojmë tokën,
shtëpinë tonë të përbashkët”,
Shkodër, më 11 dhjetor 2018)

6. Shejkh Ahmed Keftaro, Min Hedjil-Kur’anil-Kerim, Damask, 1990, f. 260-261.

7. Transmetuar nga Imam Ahmedi dhe Ibn Hibbani.

8. Shejkh Ahmed Keftaro, Min Hedjil-Kur’anil-Kerim, Damask, 1990, f. 262.

10. Transmetuar nga Tabarani, nga Rebja ibn Amr El-Xhureshi (r.a.).

REFLEKTIME XHUMAJE...

Duhet të kemi kurajon e besimit dhe të qytetarisë, të ngrihemi për të kundërshtuar të keqen dhe nxitjen përherë në rritje drejt shturjes, afetarizmit dhe imoralitetit, që don t’i marrë frymën vendit!

Fjala bie: çfarë kërkon reklama e madhe e mishit të derrit, në fytyrë të rektoratit, pesë hapa larg bibliotekës së qytetit dhe xhamisë së Parrucës?! (Pa përmendur reklamimin publik të alkoolit, veshjeve intime, e të ngjashme, që të gjitha së bashku vërtetojnë se dikujt, a shumëkujt në këtë qytet i ka rënë cipa e fytyrës në tokë!?)

Ose, çfarë kuptimi ka ajo masë e madhe prej hekuri, me shkrimin: “Kamikaze”, si dhuratë e Bashkisë tonë, aty përballë xhamisë?!

Dmth, sa e sa predikime e konferenca, takime e sensibilizime kundër terrorizmit e ekstremizmit dhe ja, dhurata e madhe e “festave të fundvitit”: Kamikazja e dashur për fëmijët e lumtur të Shkodrës?! Kjo është lajthitje kolektive!

Ose, kujt ia kanë borxh zhurmën krejtësisht të papranueshme të bokseve “të çmendura”, banorët e Parrucës, sidomos ata te pallati kinez?!

Ndoshta, Bashkia duhet të bëjë llogari të reja, sidomos me politikën e saj në lagjet muslimane të Shkodrës, që jo vetëm janë krejtësisht të lëna pas dore, por nga viti në vit, ka një tendencë përherë në rritje të promovimit ndër të një modeli dhe një frymë, që nuk shkon, as e duam në mesin tonë! Ne muslimanët kemi tjetër kulturë dhe

tjetër frymë! Ata e dinë, por bëjnë sikur s’e dinë!

Mos e tejkaloni masën dhe kufirin, se çdo gjë e ka një kufi!

Islami është fé e dijes që ndërton, nëpërmjet të cilës zhvillohet vendi dhe shoqëria, në duart besnike të baballarëve të urtë, që punojnë dhe shpenzojnë për fëmijët dhe rininë, që të rriten në kushte normale për jetën e tyre, sidomos atë studentore, teksa e kërkojnë dijen për të qenë nesër dikush që kontribuon për shoqërinë dhe vendin!

Në momentin, kur fëmijëve dhe të rinjve tanë i errësohet drita e diellit dhe e shpresës; kur detyrohen të bëhen pjesë e një sistemi të gangrenizuar e të korruptuar arsimor; kur abuzohet me dijen, kushtet për zënien e saj dhe zhvillimin normal të jetës së tyre si studentë; kur u vështirësohet jeta në vendlindje, sa detyrohen të largohen si të dëbuar me dhunë; kur dijes i hiqet shenjtëria dhe madhështia legjitime, me të cilën e ka zbkuruar Zoti i gjithësisë; e tërë kjo shënon alarmin e madh të degradimit të vendit dhe shoqërisë!

Përballë kësaj katrahure, është e ndaluar heshtja, sepse në këtë moment, heshtja, është e barazvlefshme me miratimin e shkatërrimit dhe degjenerimit, që vret dhe shfaros të ardhmen e sigurt të kombit, vendit e shoqërisë!

Imam Muhamed B. Sytari

Myfti i Zonës Shkodër

Shkodër, e xhuma, 14 dhjetor 2018





Arben Halluni, teolog

TOKA JETON PA NE, POR NE NUK MUND TË JETOJMË PA TE!

Mirësitë e Zotit të cilat e kanë shoqëruar njeriun janë të shumta, mirëpo një ndër ato mirësi me të cilat e begatoi i Madhi Zot krijesën njeri është bërja e tij si zëvendës i Zotit mbi tokë dhe detyrimi i engjëjve për t'ju përlulur e për t'i bërë sexhde atij në shenjë respekti.

Nëpërmjet këtij ajeti Kur'anor na bënë me dije bashkëbisedimin dhe konsultimin në mes veti, para se të fillojmë ndonjë punë të rëndësishme. Ta bashkëbisedojmë paraprakisht ndërmjet veti dhe pastaj ta fillojmë atë...

Prandaj, Allahu (xh.sh) para se ta krijonte Ademin (a.s), u konsultua me melekët, dhe u tregoi për krijimin dhe përcaktimin e tij si halife-mëkëmbës.

Ai tha: "Unë di atë që ju nuk e dini!"

Me këtë Zoti Fuqiplotë, deshi t'ua bënte me dije engjëjve se Ademi, njeriu i parë i njerëzimit është më i virtytshëm dhe më meritor për të qenë zëvendës i Tij në sipërfaqen e tokës. Krijimi i tij dhe përcaktimi i tij si zëvendës ndoshta kishte atë dobësinë, por dobia për të krijuar një krijesë të këtyllë është më e madhe dhe kishte urtësinë e sajë.

Kur Zoti yt u tha engjëjve: "Unë po krijoj një njeri nga balta".

Në këtë kontekst bëhet pyetja se pse Zoti e zgjodhi dheun dhe ujin si bazë të krijimit të njeriut dhe nuk zgjodhi diçka tjetër, si p.sh. hekurin?

Dheu dhe uji janë zgjedhur si substancat bazë të krijimit të njeriut, pasi janë elementet më të pastra dhe kanë veti pastruese. Vetë uji në natyrën e tij është i pastër dhe përdoret për të pastruar. I pastër është edhe dheu, të cilin e përdorim për tejmum në rast mungese të ujit.

Profeti Muhamed (a.s) thotë: "Më është bërë toka e vlefshme për falje(namaz) dhe pastërti". Me këtë fakt, Zoti dëshiron të na thotë se ti o njeri që në origjinë je i pastër dhe i paqhtë më të gjitha krijesat, të kam krijuar nga substancat më të pastra, prandaj ruaju që të mos e ndotësh këtë pastërti me gjynahe. Zoti njeriun e ka krijuar të pastër, nëse ai e ndotë këtë natyrë të pastër të krijimit të tij dije se e ka ndotë vetë, duke bërë sende dhe vepra të cilat ja ka ndaluar Krijuesi i gjithësisë në katalogun e tij, i cili shërben për të ruajtur natyrën e tij të pastër. Në moment kur ai zhytet në harame dhe mëkate dije se me to e ka ndryshuar natyrën e tij të pastër të krijimit.

CILËT JANË FAKTORËT E MJEDISIT NË KUR'AN:

1-Krijimi i ekzistencës

Argumenti i parë që bën lidhshmërinë e Kur'anit me ekzistencën, është realiteti i shprehur në të, se ajo është krijuar nga asgjëja. "Ai (All-llahu) është që krijoi (pa kurrfarë shembulli) qiejt dhe Tokën..." (El-Enam, 101)

2-Uji si burim jete

Uji në Kur'an pasqyrohet si burim i jetës: "... edhe ujin e bëmë bazë të jetës së çdo sendi; a nuk besojnë?" (Enbija, 30)

3-Detet dhe oqeanet

Zoti në Kur'an thotë: "Zoti juaj është Ai që për ju mundësoi lundrimin e anijeve në det, në mënyrë që të kërkonin nga të mirat e Tij. Vërtet, Ai është shumë mëshirues ndaj jush". (Isra, 66)

4-Retë dhe shiu

Kur banorët e Mekës kërkuar nga

Çdo gjë që ekziston në planetin Tokë është në shërbim të njeriut. Që nga lindja, e deri në momentin e vdekjes, njeriu është në kontakt të pandërprerëve me tokën, pra mjedisin. Njeriu nga mjedisi merr gjithë elementet e nevojshme për jetë.

Atmosfera është shtresa e gaztë e Tokës, dhe luan një rol të dyfishtë për zhvillimin e jetës në të. Është një shtresë vitale që ushqen jetën në Tokë, si dhe mbron Tokën nga veprimet e dëmshme të hapësirës së jashtme...

Sipas, Librave të Shenjtë, si p.sh: Kur'ani Famëlartë e tregon si vijon kështu ekzistencën dhe rolin e njeriut në këtë Tokë:

1. Për të banuar aty, natyrisht përpara se të jetosh duhet ndërtuar, zhvilluar në të gjitha fushat si dhe shfrytëzuar begatitë e Zotit në Tokë. Në ajetin 61 të sures-kapitës "Hud" thuhet: "...Dhe ju bëri banues të tij -Tokës...".

2. Për të adhuruar Zotin Fuqiplotë, bazuar në ajetin 56 të sures "Edh-Dharijat": "...Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit, pos të më adhurojnë".

3. Për të qenë mëkëmbës i Zotit në Tokë. Ajeti 129, i sures "El-Araf" thotë: "...E juve do t'ju bëjë zëvendës-mëkëmbës në këtë vend, në këtë tokë, pastaj Zoti do t'ju shikojë se si veproni...".

Pra, banimi, adhurimi dhe të qenurit mëkëmbës i Zotit në Tokë janë veprime plotësuese të njeriut, të cilat duhen marrë si synim i ekzistimit tonë në këtë jetë materiale.

Sipas, Kuranit të Shenjtë, Zoti u tha engjëjve: "Unë po krijoj (po përcaktoj) në tokë një zëvendës! Ata thanë: A do të vësh në te, atë që bënë çrregullime dhe që derdh gjaqet, e ne të madhërojmë Ty me lavdërimin Tënd dhe plotësisht të adhurojmë! Ai tha: "Unë di atë që ju nuk e dini!" (El-Bekare, 30)

Ky ajete si dhe ajete të tjera, kanë zbritur për të numëruar e për të kujtuar një mirësi të Zotit për të gjithë njerëzit.



Profeti i Islamit, mrekulli, zbriti ajeti: "Është fakt se në krijimin e qiejve e të Tokës, në ndërrimin e natës e ditës, të anijes që lundron në det që u sjell dobi njerëzve, në atë shi që e lëshon All-llahu prej së larti e me të ngjall tokën pas vdekjes së saj, dhe në të përhap gjallesa të çdo loji, në qarkullimin e erërave dhe reve të nënshtruara në mes qiellit e Tokës, (në të gjitha këto), për një popull që ka mend, ka argumente". (El-Bekare, 164)

Kjo tregon që mrekullia më e madhe dhe e përhershme është bota që na rrethon, në të cilën mund të gjejmë argumente të pafund për ekzistimin e Zotit dhe për Teuhidin e Tij, ndërsa shiu është vetëm njeri prej atyre argumenteve.

Pra, Toka është përgatitur për njeriun në një sistem të veçantë furnizues me ujë, e gjithë kjo për zhvillimin dhe jetesën e krijesave.

5-Bubullima dhe Vetëtimja

Bubullima, vetëtimja dhe rrufeja, nga këndvështrimi kur'anor, janë krijesa të Zotit Madhniplotë, që e madhërojnë dhe e përmendin. Në Kur'an ka bërë një krahasim mahnitës në mes bubullimës dhe engjëjve: "Ndërkaq, murmurima madhëron (Zotin një) me falënderimin (që i takon) e Tij, (e madhërojnë) edhe engjëjt nga droja ndaj Tij". (Err-Rrad, 13)

6-Bjeshkët

Ai që krijoi krijesat si dhe qiejt pa asnjë shtyllë, është Ai që ka krijuar bjeshkët me përforcime, vetëm e vetëm që të mos e dëmtojnë njeriun: "Dhe Ai është, i Cili tokën e shtriu, dhe në të krijoi kodra e lumenj...". (Err-Rrad, 3)

7-Kafshët amaneti i Zotit për njeriun

Në realitet, koncepti i natyrës që e qartësoi Kur'ani, mbështetet kryekëput në faktin se të gjitha krijesat, qofshin ato të gjalla a të vdekura, përfshirë këtu dhe njeriun, janë krijesa të Allahut (xh.sh). Në këtë kontekst njeriu dhe natyra nuk janë elemente të ndara e të panjohura nga njëri-tjetri. Përkundrazi, ato janë një tërësi e krijuar nga Krijuesi. Njeriu është obliguar që me natyrën dhe krijesat në të, të veprojë me përgjegjësinë më të madhe. Natyra nuk është pronë e njeriut, por e Zotit. Natyra i është nënshtruar njeriut që të veprojë në të, por brenda kufijtë e rregullave të veçanta.

Njeriu, ndaj natyrës duhet të veprojë patjetër në një formë etike, aq sa të ketë dobi prej saj dhe ta përdorë atë.

Si përfundim, çdo gjë që gjendet rreth nesh, në tokë quhet mjedis. Në jetojmë në këtë mjedis dhe jemi pjesë e tij. Mjedis, i cili jeton edhe pa ne, por ne nuk mund të jetojmë pa te, ka ofruar shumë gjëra që ne të përfitojmë duke i

shfrytëzuar të mirat e tij. Ai na dhuroi natyrën, ajrin, ujin, shtazët, bimët, pasurit nëntokësore, etj. Toka është trupi dhe shpirti i njerëzimit. Vetë njerëzit e kanë ushqyer dhe ndonjëherë po ata vetë e shkatërrojnë. Këtë e citon edhe Zoti në Kur'an: "Mos bëni çrregullime në tokë, pas rregullimit të saj...". (El-Araf, 56)

"Një komb që shkatërron tokën e vet, shkatërron veten", ka deklaruar Franklin D. Roosevelt, presidenti i 32-të i ShBA-së.

Prandaj, ta ruajmë tokën, që është i vetmi planet me çokollatë!

Kjo thënie, vite me parë ka qenë pjesë e shumë fushatave të organizuara nëpër botë me qëllim të sensibilizimit të opinionit të gjerë për rrezikun që po i kanoset tokës nga ndryshimet klimatike.

Përveç shumë përpjekjeve diplomatike dhe shkencore në nivelin global, ish-diplomati amerikan, Al Gore pas suksesit të arritur me filmin dokumentarë "E vërteta e pakëndshme" që i kushtohet ndryshimeve klimatike, ka vazhduar fushatën "Earth Live", me qëllim të njëjtë për t'i rikujtuar sërish njerëzimit për rrezikun që po i kanoset tokës nga ndryshimet klimatike...

Të gjendur para një situatë të tillë shtrihet pyetja: A mundet secili prej nesh në mënyrë individuale të kontribuoj në uljen e këtij rreziku!?

Natyrisht se po, çdo person do të mund të japë kontributin e vet në të mirë të kësaj çështjeje, nëse marrim për bazë thënien "Mendo globalisht, vepra lokalisht"!

Shumë veprime tona lokale që në shikim të parë nuk duket të efektshme, mund të kontribuojnë mjaft në uljen e rrezikut nga ngrohja globale dhe në përmirësimin e gjendjes së mjedisit në përgjithësi, sikurse të kontribuojmë gjithashtu edhe në aspektin e uljes së rrezikut nga fenomenet e tjera që po e ndotin më shumë se asgjë tjetër shtëpinë tonë të përbashkët, Tokën tonë të shenjtë siç janë: krimet, dhuna, gjakmarrja, prishja e moralit nga shfrenimet pakufi, droga, alkooli, kumari, martesat brenda llojit ose të të njëjtës gjini, padrejtësitë, etj, etj.

Uroj dhe lutem që tokën ashtu siç Zoti e ka krijuar të paqhtë dhe të begatë, ashtu ta ruajmë të paqhtë si dhe ta zhvillojmë e përparojmë atë më tej, më begatitë e Krijuesit tonë të përbashkët, Zotin Fuqiplotë, të cilat janë të pafund...

Referat i mbajtur në konferencën ndërfaqësore me temë:

"Të mbrojmë tokën, shtëpinë tonë të përbashkët", Shkodër, më 11 dhjetor 2018)

MYFTINIA URON KOMUNITETET E KRISHTERA

Përfaqësues të Myftinisë Shkodër, zhvilluan ditën e martë, më 25.12.2018 vizitat tradicionale në Kishën Ortodokse Shkodër dhe në Arqipeshkvinë Metropolitane Shkodër-Pult, ku u pritën nga drejtuesit e dy komuniteteve të krishtera të Shkodrës.



Në emër të Myftinisë dhe Myftiut të Shkodrës, H. Fejzi Zaganjori përcolli urimin me rastin e kësaj dite, duke i uruar besimtarëve ortodoksë dhe katolikë lindjen e Jezusit, Hz. Isa it (a.s).

Ndërsa përpara mediave, me këtë rast teologu Arben Halluni, ku në emër të Myftinisë Shkodër uroi për më shumë harmoni e mirëkuptim në mesin e besimtarëve dhe të gjithë njerëzve kudo në botë.

Në atmosferën e festave fetare duhet që të gjejë më tepër hapësirë paqja e mirësia, falja dhe përlësia, – tha ndër të tjera teologu Halluni. Ai në mesazhin e tij, para mediave iu drejtua me një thirrje për të gjithë ata që janë në gjakmarrje, që të shtrijnë dorën e pajtimit dhe të falin për hir të Zotit Fuqiplotë, sepse askush nuk ka të drejtë të çënojë apo dhunojë jetën e tjetrit.

Këto vizita ndihmojnë në forcimin e frymës së bashkëjetesës dhe harmonisë ndërfaqësore në mesin e tri besimeve fetare në Shkodër.



Naim Drijaj,
Imam - xhamia Parrucë

STINA E DIMRIT DHE BESIMTARI

ndieni vapën më përvëluese, ndërsa frymëmarrja e dimrit është kur ju ndieni të ftohtin më të egër.”⁴

Ibn Abasi (r.a) ka thënë: “Banorët e zjarrit kërkojnë ndihmë për të nxehtin dhe ju jepet një erë, i ftohti i së cilës u copëton eshtrat, kështu që kërkojnë prapë të nxehtin”.

Transmetohet se Ka’bi ka thënë: “Në xhehenem është një i ftohtë që quhet zemherir. I ftohti i tij qëron mishin, e kështu detyrohen të kërkojnë ndihmë nga i nxehti i xhehenemit.”⁵

Jahja ibn Muadh ka thënë: “Nata është e gjatë dhe mos e shkurtro me gjumë. Islami është pastërti, andaj mos e ndot me gjynahet e tua.”⁶

Është transmetuar nga Abdullah ibn Mes’udi (r.a) se kur hynte stina e dimrit thoshte: “Mirë se erdhe stina e dimrit, në të zbret begatia, në të zgjatet nata për namaz dhe në të shkurtohet dita për agjërim.”⁷ Hasen el-Basriu, Allahu e mëshiroftë ka thënë: “Sa kohë e mirë është stina e dimrit për besimtarin! Nata e saj është e gjatë dhe zgjohet për namaz, ndërsa dita është e shkurtër për të agjëruar.”⁸

Ubejd ibn Umejri, Allahu e mëshiroftë, kur vinte stina e dimrit thoshte: “O pasuesit e Kur’anit, është zgjatur nata juaj për leximin tuaj, ndaj lexoni (Kur’an), dhe është shkurtuar dita juaj për të agjëruar, prandaj agjëroni!”⁹

Tregohet se Safvani dhe shumë të tjerë, Allahu i mëshiroftë, faleshin me një teshë të hollë netëve të dimrit, në mënyrë që i ftohti t’ua largonte gjumin. Prej tyre kishte që nëse koteshin nga

gjumi, lagnin fytren me ujë dhe thoshin: “Kjo është më e lehtë se uji i qelbur i xhehenemit.”¹⁰

Ata el-Hurasani, Allahu e mëshiroftë, i thërriste shokët e tij natën duke u thënë: “O filan, o filan, o filan! Ngrihuni, merrni abdest dhe faluni! Ngritja për t’u falur gjatë natës dhe agjërimi gjatë ditës janë më të lehta se pirja e ujit të qelbur dhe rrobat prej hekurit nesër në xhehenem! Shpejtoni, shpejtoni në mënyrë që të shpëtoni!”¹¹

DISA LUTJE:

1- Çfarë duhet të themi me rastin e fryrjes së erës?

Aishja (r.anha) tregon se kur frynte erë, Pejgamberi (a.s) thoshte: “O Allahu im, unë kërkoj nga Ti të mirat e saj, të mirat që gjenden në të dhe të mirat me të cilat është dërguar dhe kërkoj mbrojtje nga Ti, nga e keqja e saj, nga e keqja që është në të dhe nga e keqja që është dërguar me të!”¹²

2- Çfarë duhet të themi kur dëgjojmë bubullimën?

Është transmetuar nga Abdullah ibn Zubejri (r.a) se kur dëgjonte zërin e bubullimës, ndalej nga të folurit dhe thoshte: “I Lartësuar është Ai që “Bubullima e madhëron Atë me falënderim...”¹³ Pastaj thoshte: “Vërtet ky është një paralajmërim i madh për banorët e Tokës.”¹⁴

3- Çfarë duhet të themi kur bie shi?

Është transmetuar nga Aishja (r.anha) se i Dërguari i Allahut (a.s) kur shihte shiun duke rënë thoshte: “O Allahu im, bëje zbritjen e tij të dobishme!”¹⁵

1. Kur’ani, Err-Rrad: 13.
2. Kur’ani, Err-Rrad: 13.
3. Kur’ani, En-Nur: 43.
4. Buhariu, nr. 3260, Muslimi, nr. 617.
5. Ibn Rexheb, “Lataiful Mearif”, fq. 218.
6. Ibn Rexheb, “Lataiful Mearif”, fq. 216.
7. Ibn Rexheb “Lataiful Mearif”, fq. 558.
8. Po aty.
9. Po aty.

10. Po aty fq. 562.
11. Po aty.
12. Muslimi (899).
13. Kur’ani, Err-Rrad: 13.
14. Edeb el-Mufred (556).
15. Buhariu (1032).

PROF. XHEVAT KUÇI, OSE “E NDRIÇOI XHAMINË TONË, E NDRIÇOFTË ALLAHU!”

Në jetën tonë të përditshme, mund të përballemi me njerëz të cilët në një mënyrë apo një tjetër, mundohen që të shfaqin interesimin e tyre për të bërë mirë.

Një vepër sado e vogël, sado e papërfillshme në syrin tënd apo në syrin e të tjerëve, por nuk dihet se sa është vlera e saj tek Allahu i Madhëruar.

Në mesazhin që dua të ndaj me ju sot, nga xhamia e “Dy Vajzave”, është pikërisht kjo lulishte e vogël, me këto gurë të lyster e të rregulluar, me këto pemë të sistemuara mirë.

Kjo është puna e një intelektualit të nderuar, e një pensionisti të dashur, prof. Xhevat Kuçi. Ai pothuajse çdo ditë vjen dhe interesohet për këtë lulishte, e mirëmban atë, në fakt ai vetë e ka krijuar këtë; ai vetë e ka zbukuruar dhe e ka krijuar modelin e kësaj lulishteje që e hijeshon xhaminë.



Dikush mund të mendojë që kjo është diçka e thjeshtë, diçka e vogël, diçka e papërfillshme.

Një pemë, dy pemë, një lule, dy lule, ama në të vërtetë kjo më kujton shembullin e sahabiut të nderuar Temim Ed-Dariu, i cili erdhi një ditë në xhaminë e Pejgamberit (a.s). Normalisht para 15 shekujsh xhamitë nuk kishin pamjet e xhamive të sotme, ishin shumë të thjeshta por kishin përmbajtje, kishin shpirt, ishin burim i edukimit, ishin burim i të mirës, gjithësesi xhamia e Pejgamberit (a.s) kishte Pejgamberin (a.s) dhe kjo i mjafton asaj nder dhe lavdi dhe shembull për t’u marrë deri në ditën e gjykimit!

Temim Ed-Dariu (Zoti qoftë i kënaqur prej tij) pa se xhamia e Pejgamberit (a.s) nuk kishte ndriçim natën, pra nuk kishte drita, pavarësisht se drita e gjithësisë ishte brenda saj dhe i mjaftonte kjo dritë deri në ditën e gjykimit. Vendosi që për herë të parë në historinë tonë të ndriçonte një xhami nëpërmjet fenerëve, nëpërmjet kandilave me vaj, dhe në

çdo cep të xhamisë vendosi kandila të shumtë. Kur e pa Pejgamberi (a.s) këtë vepër, pyeti se kush e kishte bërë? Kush ishte autori i saj? I treguan që autori i saj është sahabiu i nderuar Temim Ed-Dariu. Pejgamberi (a.s) tha: “E ndriçoi xhaminë tonë, e ndriçoftë Allahu!”

Pra, në pamje të parë dikush mund të mendojë, ajo është një vepër e thjeshtë, ajo është një vepër e papërfillshme, ajo është një punë që mund ta kisha bërë edhe unë, këtë punë e bën gjithkush, nuk ka bërë diçka të madhe.

Jo, tek Allahu i Madhëruar dhe në sytë e Pejgamberit (a.s) ajo meriton bekimin e madh: “E ndriçoi xhaminë tonë, e ndriçoftë Allahu!”

Është njësoj sikur t’i themi sot prof Xhevat Kuçi: E zbukurove xhaminë tonë, Allahu e zbukuroftë jetën tënde! E pastrove xhaminë tonë dhe oborrin e saj, Allahu të pastroftë nga çdo e keqe dhe



largoftë çdo pengesë nga jeta jote dhe nga të dashurit tuaj!

Pra, të dashur e të respektuar vëllezër, ka një rast, ka një shembull, ka një fjalë të artë në fenë tonë: Mos e nënvlerëso asnjëherë të mirën! Mos e nënvlerëso asnjëherë punën e dobishme, sado e vogël që të duket ajo në sytë tuaj dhe sado e vogël që mund t’i duket ndokujt tjetër!

Jo, ne nuk mund të lejojmë dhe nuk duhet të lejojmë që të tjerët ta nënvlerësojnë punën tonë, dhe nuk duhet t’i lejojmë vetvetes që të na pengojë për ta vepruar të mirën.

Sikurse kanë thënë: Bëje të mirën dhe hidhe në det, po nuk e pa peshku, e sheh Zoti vet.

Allahu e shpërbleftë prof. Xhevat Kuçin për këtë punë të mirë dhe për shembullin e tij pozitiv!

Allahu ju dashtë dhe ju nderoftë, lutuni për njëri-tjetrin dhe punoni për të mirën.

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

LOTI I MUSAIT DHE LOTI I SHPRESËS...

Dergjej në krevat prej tre muajsh, derisa një çast, rasti erdhi tek Elvisi. Drita e vetme e syve të nënës së tij. Sa lot ka derdhur ajo nënë, që nga dita kur mësoi se i biri shkoi të lahej për të mos u kthyer më me këmbët e veta.



Këtu dua ta ndalem, sepse shkak që Musai të vinte gjallë ishin dy të rinj bashkë me mamanë, heronj të vërtetë, e shpëtuan Musain, e nxorën në breg, i dhanë frymëmarrje artificiale, i dhanë mundësinë për të jetuar.

Pastaj Elvisi e publikoi këtë rast e më pas Sidriti gjatë vizitës së tij përlotet, një rast i vështirë. Musai nuk e ka babanë, asnjë dite nuk është kujdesur për të.

Lotët e Musait mjekët nuk i shpjegojnë dot, as reagimet e tij, por mijëra shqiptarë janë lutur, mijëra shqiptarë u bënë bashkë për ty Musa; lotët e tua ishin shpresë për ty, por më shumë për shoqërinë tonë, për të vrarë indiferencën. U shpëtua një jete. Po, po, u shpëtua një jetë nga kthetrat e vdekjes së indiferencës.

Loti i Musait më preku, aty e kuptova insistimin e Elvisit për ta marrë si rast; kuptova lotët e Sidritit; kuptova lutjet e një shoqërie që Musai të shpëtojë; kuptova se mes nesh ka energji pozitive, vetëm duhet ta duam njëri-tjetrin edhe kur nuk jemi duke u mbytur, sepse jeta bëhet më e bukur me dashuri.

Loti i Musait ishte loti i shpresës së një shoqërie, që bashkë me Musain dëshiron të ringrihet në këmbë. Zot! Ne e bëmë atë që Ti na ke porositur, ndaj të lutem shëroje Musain të rikthehet si një buzëqeshje shprese për mbare ne...

Ilir Hoxholli



Zamira Puka, teologe

PËRSOSJA E VLERAVE TË MORALIT SI PASQYRIM I KËSHILLAVE TË PROFETIT (A.S) NË JETËN TONË

vërtetë, ti (o Muhammed) je në shkallën më të lartë të moralit.”¹

Neve, si muslimanë, na mjafton ky pohim dhe vlerësim i Allahut (xh.sh) për Profetin (a.s), dhe nuk kemi aspak dyshim se shembulli më i mirë për t'u ndjekur për ne është shembulli i Profetit Muhammed (a.s). Por, pyetja që lind është se a jemi ne, sot, si muslimanë, duke ndjekur rrugën e tij ashtu siç thotë Profeti (a.s): “Me të vërtetë unë jam dërguar që të plotësoj virtutet e larta morale.”²

Sot, po jetojmë në një kohë ku njerëzit po rendin të plotësojnë kënaqësitë dhe dëshirat e tyre, pa përfillur aspak normat e moralit dhe kodin etik, ku krahas krizës ekonomike, kriza morale është bërë tipar karakteristik i botës sonë. Po konstatojmë çdo ditë e më tepër se shturja dhe degradimi moral është plaga më e rëndë nga e cila po vuan shoqëria e sotme e sidomos rinia. E pjesë e kësaj gjendjeje është bërë edhe shoqëria islame.

Ende shumë njerëz nuk janë ndërgjegjësuar se ne mbartim mbi supë përgjegjësinë e “halifes” në tokë, që nënkupton përgjegjësinë e “mëkëmbësit të Zotit” në tokë. E veçanërisht, ne si muslimanë, që të kryejmë detyrën e “mëkëmbësit” duhet të tregojmë kujdes në realizimin e qëllimit të krijimit tonë, sepse përveç adhurimit të Allahut (xh.sh), ne kemi si qëllim edhe përsosjen e moralit njerëzor. E nuk duhet të harrojmë se misioni fisnik në të cilin u dërgua Profeti ynë i dashur, Muhammedi (a.s) ishte përsosja e virtyteve të larta morale dhe jetësimi i vlerave humane.

E ne jemi të vetëdijshëm se këtë mision i Dërguari i Allahut, Muhammedi (a.s) e përmbushi në formën më të mirë, sepse ky konstatim ka ardhur nga vetë Allahu xh.sh, i cili ka thënë: “Me të

muslimanëve nuk përkon me besimin që mbartin, atëherë dëmtojnë besimin e punën e tyre, por edhe imazhin e islamit dhe të muslimanëve tek të tjerët. E veçanërisht nëse bashkëjetojmë me njerëz të besimeve të tjera që nuk e njohin Islamin ose janë keqinformuar për të, pasojat e kësaj sjelljeje janë më të rënda. Kur sahabët e pyetën Profetin (a.s) për një grua e cila falte namaze vullnetare, agjëronte, lexonte Kur'an, por ajo shqetësonte komshinjtë me gjuhën e saj; Profeti (a.s) u përgjigj: “Nuk ka mirësi në të, ajo është në zjarr.”⁴

Pse ka kaq shumë rëndësi sjellja dhe morali i mirë për besimtarin musliman?

Ne gjykojmë rreth besimit të dikujt sipas sjelljes dhe moralit të tij me personat që ka përreth, sepse besimi është në zemër e nuk mund të shihet, por ky besim pasqyrohet në sjellje. Për këtë Ibn Kajimi ka thënë: “Besimi është morali i mirë, ai që ka shtuar moralin e mirë ndaj teje, ka shtuar besimin”.

Po t'i kthehemi qëllimit të dërgimit të Profetit tonë të dashur (a.s), që është të stolisemi me moralin e tij dhe të fisnikërohemi me sjelljet dhe veprat e tij të bukura, patjetër që mahnitemi me sjelljen e tij të mirë me njerëzit, sidomos me familjarët, të afërmit dhe shokët e tij. Në këto rreshta është e pamundur që të flasim për moralin e Profetit (a.s), por do të përmend disa nga thëniet e Profetit (a.s) që tregojnë rëndësinë e moralit të mirë si në këtë botë ashtu edhe në botën tjetër.

Profeti (a.s) ka thënë:

- “Nuk ka gjë më të rëndë në peshoren e robit Ditën e Kjetimit, se sa morali i mirë.”⁵

- “Me të vërtetë njeriu mund të arrijë me moralin e tij të mirë, gradat e atij

që agjëron (nafle) dhe falet (natën).”⁶

- “A t'ju lajmëroj me më të dashurit e mi dhe me më të afërmit pranë meje Ditën e Kjetimit”? I thamë: “Po, o i Dërguari i Allahut”. Tha: “Ata me moralin më të mirë.”⁷

E cili nuk dëshiron që të jetë në xhenet me Profetin (a.s)! Por, moralet e mira dhe përsosja e tyre mund të arrihet me anë të dy gjërave kryesore: Mosndjekja e epshit dhe largimi nga vesveset e shejtanit. Nëse i bëjmë këto të dyja, atëherë kemi përmirësuar sjelljen tonë.

Mos të harrojmë se karakteristikë e kësaj feje është morali i mirë, është bashkëpunimi i mirë, është lidhja e mire mes teje dhe Allahut, por edhe lidhja e mire mes teje dhe njerëzve të tjerë. Ymeti islam në tërësi i ngjan një peme, e cila mbin me njohjen e Zotit; ushqehet me adhurimin dhe lidhjen me Zotin, ndërsa frytet e saj janë moralet e larta, edukata dhe mirësjellja. Janë frytet ata që tregojnë se sa mirë ushqehet kjo pemë dhe sa kujdes është treguar për të.

Le të mendohejmë që të përmirësojmë moralin tonë, sjelljet tona me njëritjetrit, të largohemi nga veset e këqija si smira, zilia, përgojimi, dyfytirësia, etj. Le të përpiqemi që në jetën tonë të kristalizojmë dhe të praktikojmë vlerat morale për të cilat na ka porositur Pejgamberi ynë, sepse kështu arrihet që të fitojmë kënaqësinë e Allahut, por edhe ndjekjen e shembullit të njeriut më të dashur, Muhammedit (a.s).

Lus Allahun (xh.sh) që të na bëjë prej muslimanëve, besimtarëve, të devotshmëve, të moralshmëve, ndjekësve të porosive profetike, si edhe shembull për fëmijët tonë dhe për brezat që do të vijnë. E prej atyre që i shpërblen me xhenetin Firdeus! Amin!

1.Kur'ani, El-Kalem: 4.

2.Hadith hasen, tansmeton Ahmedi, nga Ebu Hurejra (r.a).

3.Hadith hasen sahih, transmeton Tirmidhiu nga Ebu Hurejra (r.a).

4.Hadith sahih, transmeton Hakimi, Ahmedi dhe Bejhaku nga Ebu Hurejra (r.a).

5.Hadith hasen sahih, transmeton Tirmidhiu nga Ebi Derda (r.a).

6.Ttransmeton Ebu Davud, nga Aisheja (r.a).

7.Hadith hasen, transmetohet nga Ahmedi, Tirmidhiu dhe Ibn Hibban, nga Ebu Tha'lebe El-Hasheni.

MJESHTRI I MERMERIT

Një herë e një kohë jetonte një mjeshtër që gdhendte mermer pranë një mali nën rrezet përvëluese të diellit. Mjeshtri i mermerit i lodhur nga puna e rënde që bënte ankohej duke thënë: “U mërzi nga kjo jetë! Gdhend e gdhend! Vdiqa! Sikur të mos mjaftonte, ç'është edhe ky diell kështu? Ky diell përvëlues! Ah! Ah! Sa do doja të isha në vendin e tij. Ah sikur të isha diell! Atje në lartësitë e qiejve do zotëroja gjithçka, do ndriçoja me dritën time anë e kënd botës...”

Mjeshtrit i plotësohet dëshira dhe mrekullisht shndërrohet në diell. Tanimë mjeshtri i mermerit është bërë dielli i qiellit dhe ndihet shumë i lumtur ngase dëshira i është plotësuar. Papritmas mu atëherë kur po përgatitej të rrezatonte dritën e tij, vëren se disa re po e pengonin. Për këtë rebelohet duke thënë: “Ç'vlerë ka të jem diell kur këto re të thjeshta janë aq të fuqishme sa të më presin dritën time!”

Mendon: “Meqë këto janë më të fuqishme se dielli atëherë preferoj të bëhem re...”

Mrekullia vazhdon dhe mjeshtri i mermerit menjëherë shndërrohet në re. Kështu fillon të fluturojë mbi botë, vë vrapojë sa andej këndeje e të dhurojë shi, por pa pritmas përpara shfaqet era që e shpërndan gjithandej. Këtë herë është i vendosur: “Erdhi era dhe më shpërndau. Do të thotë që era është më e fuqishme. Më mirë të bëhem erë.”

Kur bëhet erë, frynë gjithandej nëpër botë, sjell furtuna e tornado, por papritmas një mur i madh i del përpara dhe e pengon. Ç'të shohë? Ky mur i lartë dhe i fortë që e pengon të fryjë është një mal.

Këtë herë thotë: “E ç'mu desh të isha erë, kur një mal i thjeshtë mjaftoi të më ndalonte?” Prandaj dëshiron të bëhet mal dhe menjëherë dëshira i realizohet. Pas një farë kohë ndjen që diçka po e godiste në mënyrë të vazhdueshme. Bëhet kureshtar të mësojë ç'të jetë vallë ajo gjë më e fuqishme se vetë ai e që e gdhendte pa pushim...

Ç'të shohë? Ajo dorë e vogël ishte dora e një mjeshtri mermeri...

Njeriu duhet të jetë falënderues për çfarë ka dhe nuk duhet ta i thotë jetën e tij duke kërkuar pambarimisht atë që nuk e ka. Natyrisht që do kemi kërkesa, dëshira dhe ëndrra. Për sa kohë jetojmë e frymojmë sigurisht që do kemi edhe kërkesa. Por, duhet të dimë vlerën dhe të falënderojmë për çfarë kemi dhe të mos jemi në ndjekje të ëndrrave boshe të cilat nuk i njohim thellësisht.

Kush e di, mbase jeta për të cilën ankohejmë, për të tjerët mund të jetë jeta e ëndërruar.

Ferudun ÖZDEMİR

Përktheu nga turqishtja dhe përshtati në shqip:

Elona SYTARI



MË E BUKURA ËNDËRR...

Eshtrenjta ime, kur ti humb në petale lulesh të gjej mbuluar me vesë mëngjesi. Mbi buzët e tua është derdhur pjalmi i çdo luleje plot aromë. Buzëqeshja jote më vjen si tufë karajfilash, e unë gëzohem për këtë çast, të gjej atje të fshehur, veshur me fustanin qiellor, e sheqerosur me petale të kuq karajfilash. Uh, sa shumë lumturohem atë çast! Dhe çasti gënjeshtar vazhdon të më kënaqë.

Në tabllon mbi shtratin tim, një mbrëmje të gjeta atje. Vështroja e menduar dhe në atë tablo nuk shihja një grua me trup të gjatë, me flokët rredha – rredha siç i kishe ti, si zanë, nuk kishte as sy të heshtur që sa herë më vështronin diku lëshonin rreze drite. Në tablo kishte pranverë, atë që deshe ti e që të mori në përjetësi. Me zambakë të bardhë dhe karajfila të kuq të kërkova ty e mes ngjyrash sytë e mi të panë. Zemra sa nuk po më dilte vendit. Jam djegur prej mallit tënd që kurrë nuk po mbaron. Marr frymë e shpirti më dhemb, sepse ti më mungon.

Dalëngadalë kam filluar të kuptoj se nuk vjen më, se unë tashmë jam e vetmuar e se zemra ime është e ndarë në copëza të vogla, ku gjithsecila më jep dhimbjen e saj. Si gjithnjë, pjesëza jote rri e fshehur dhe qan në heshtje, dëgjoj rënkimet e saj dhe unë pezmatohem, çdo pikë loti e jotja më dhemb. Ti ke frikë se ndoshta nuk do ta njohim njëra – tjetrën, sepse koha na ndau para kohe. Unë vërtetë pak gjëra mbaj mend, të njoh nga fotografia.

Pjesëzat e tjera të shpirtit tim dhembin, sepse trazohen, lëndohen, nga mënyra se si më flasim, se si më kuptojnë apo se si më vështronin të tjerët. Të gjithë më duan me mënyrën e vet, babi, gjyshërit, halla, tezja, të gjithë, të gjithë. Nuk e di se si do të ishte mënyra jote, por jam e bindur se unë do të ndjehesha ndryshe, do të ndjehesha si të tjerët dhe jo si ndjehem tani. E di se ti je një ëndërr e bukur që unë nuk e jetova dot, megjithatë kam kuptuar se ti je një dashuri e madhe edhe pse në mungesë.

Nga natyrshmëria jote mundohem të fitoj gjithçka, urtësinë, mirësinë, besimin, sinqeritetin, heshtjen dhe dashurinë. Kur ti u fike unë isha në gjumë, krahëkëputur e kokëvarur, më

kishte kapluar gjumi i vetmisë. Miliona dhimbje mban shpirti im, përpëlitem në ëndërr si një flutur krahëkëputur dhe shpesh pyes veten se a jam unë ajo flutur, a je ti me krahë të këputur, apo jemi të dyja? Rëndësinë e pranisë tënde e kupton sa herë që mbetem vetëm dhe filloj e flas me erën, hënën, diellin, borën, shiun, lulet, zogjtë, natën, ditën, dimrin, verën, pranverën, vjeshtën.



Dhe a e di se ç'më thonë për ty e shtrenjta ime?

Era, me tregon historinë jetëshkurtër të një vajze të ëmbël.

Shiu, sa herë që bie lëshon pika të mëdha loti për ty.

Bora, vizaton në defterin e saj të bardhë portretin tënd.

Hëna, më pëshpërit ato fjalë që ti dot nuk m'i the.

Dielli, më ngroh duke më këshilluar, ashtu siç do të bëje edhe ti.

Zogjtë, vijnë e më fshijnë lotët.

Lulet, më sjellin ndërmend fytyrën tënde plot buzëqeshje.

Pranvera, më kujton ato pak shëtitje me karrocë që më bëje ti.

Vjeshta, më shton mallin e më trazon ëndrrat. Ah, sikur të të kisha pranë!

Vera, më shpie pranë detit ku ngushëllohem e nuk ndahem dot nga i vetmi kostum banjoje që më ke blerë ti, ta dish se sa me fanatizëm e ruaj.

Dimri, është i ftohtë, më sjell vetminë e unë strukem në shtrat e pres që ti të vish në ëndrrat e mia.

Dita, më përhum me njerëzish.

Nata, më afron pranë teje.

Sejda Teli, kl. 6-A
Medreseja "Haxhi Sheh Shamia",
dega vajzave.

E kështu filloj e flas pambarim...

*Pikturë je në sytë e mi
e s'kam ku të përqafoj,
Pikaso, të lutem në telajo
Sejdës një mundësi krijoi.*

*Nëse edhe ti nuk mundesh
Ta dish, nuk zemërohem unë, jo
Se Krijuesi i gjithësisë më thotë:
Vogëlushe mos u trishito!*

*Tek njerëzit e mirë në tokë,
Në zemër tablo ju kam krijuar,
Dashuri pafund të japin,
Kështu e kam titulluar.
E di se pikturë si mami,
Në botë, një tjetër, nuk ka,
Ndaj shpesh më mjafton të them,
Më mbro nga bota, o Allah!*

*E tillë jam unë,
Se ku plagë më shumë kam,
Dot se përcaktoj,
Gjithçka më dhemb moj mami
Se pa ty po jetoj.*

Por unë mami për ty di të them se je një dritë e parrëfyer, je gushëbardha ime e praruar mes gjithçkaje që Krijuesi na ka dhuruar. Je e vetmja me një zemër të madhe, të dhembshur, plot drithërimë për krijesën tënde të vetme që unë jam. Ti vjen në ndjesinë time si një tingull pafund, më fal qetësi, më fal ëndrrën që unë dua të shikoj, ta përjetoj e të lumturohem.

Për mua je këngë në përjetësi që dëgjoresh edhe nëse veshët nuk kanë shpresë dëgjimi. Je një cicërimë që zbrat nga retë edhe kur ato janë të zemëruara e derdhen lot, ti vjen ngadalë e futesh në shtratin tim, vetëtimthi unë hap derën e zemrës e të ruaj aty, sepse ti më jep gjumin pa andralla. Me sytë e tu të shkruar vështron përtej gjithçkaje që ekziston. Po ku je, ku je ti ëndërr e bukur, në ëndrra me sy mbyllur, në qytetin e lotëve plot lule, apo në shtëpizën zemër?

Unë tashmë e kam kuptuar dhe e di se ti do të mbetesh sirtari i mbyllur i ëndrrave të mia.

Më mungon...

MYFTIU LIGJËROI MBI THIRRJEN E RESULL-LLAHUT (A.S), SI MËSUES I TË MIRËS

Nga xhamia "Ikre" në Bruttisellen të Zvicrës, të shtunën, më 24 nëntor 2018, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, hodhi dritë mbi pozitën e lartë të Hz. Muhamedit (a.s.), si Mësues dhe Edukator, që për 23 vite e nxori shoqërinë e tij nga realitetet e zymta të anarshisë, në shembullin më të mirë për t'u pasuar deri më kijamet.

Gjatë ligjëratës, ai theksoi se gjurmët e mrekullueshme të Resull-llahut (a.s.) mbeten përherë stacione udhëzimi për shoqëritë njerëzore në çdo kohë.

"Islami është fë e kompletuar dhe garanci për të jetuar në nivelet më të larta, si njerëz të qytetëruar, besimtarë,

bashkëpunues e solidarë me tjetrin, të mbështetur në dritën e dijes së pastër, që buron nga Kur'ani Famëlartë dhe Traditat



e Mësuesit të Madh (a.s.)!", theksoi Myftiu në fjalën e tij.

Ai përshëndeti edhe imamin e kësaj xhamie, z. Shaban Azizi, si dhe kryesinë e saj, për ftesën bujare dhe mundësinë e këtij takimi me vlerë.

MYFTIU LIGJËROI NË MEVLUDIN E B.I. "AL-SHEMS"

Me ftesë të Bashkësisë Islame "Al-Shems", në Rebstein të Zvicrës, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, ligjëroi në aktivitetin e përvitshëm që organizoi xhamia "Al-Shems", me rastin e përkujtimit të Lindjes së Hz. Muhamedit (a.s.), të dielën e më 25 nëntorit 2018.

Gjatë këtij aktiviteti, Myftiu hodhi dritë mbi pozitën e lartë të Dërguarit të All-llahut, sikurse theksoi se, përtej sfidave të ndryshme të jetës, besimtari musliman është njeri optimist, i mbushur me besim dhe shpresë në mëshirën e All-llahut të Madhëruar.

Ndër të tjera, tha se: "All-llahu i Madhëruar është betuar në Kur'anin Famëlartë: "Pasha jetën tënde (o Muhammed)!", prandaj, edhe sikur shkruan Hafizi Ebu Shame (v. 665), mësuesi i Imam Neveviut:

"Ndër risitë më të mira në kohën tonë, është edhe ajo që bëhet për çdo vit në ditën përkatëse të Lindjes së tij (a.s), si ndarja e sadekave dhe shtimi i veprave të mira, shfaqja e zburimeve dhe e gëzimit. Kjo nxit dashurinë dhe madhërimin e tij (a.s) në zemrën e atij që e bën këtë vepër, si dhe falënderim ndaj All-llahut të Madhëruar për mirësinë e madhe të krijimit të dërguarit të Tij, që e dërgoi mëshirë për krejt botrat".

Myftiu falënderoi edhe imamin e xhamisë shqiptare të Rebsteinit, H. Enes ef. Koshi, si dhe kryesinë, për organizimin madhështor, si shenjë dashnie ndaj të Dërguarit të All-llahut (xh.sh.).

Në këtë aktivitet të shënuar, ligjëroi edhe Hoxha i nderuar, Nexhmedin Ademi, nga Presheva, ndërsa të pranishmit patën mundësi të dëgjonin ilahitë dhe recitimet e përzgjedhura nga Hfz. Ajdin Aliji.



MYFTIU: "KONTRIBUTET E HOXHALLARËVE PËR ÇËSHTJEN KOMBËTARE, SI YJET QË SHNDRISIN DERI NË KIJAMET!"

Me ftesë të MBS "Drita" në Londër, Myftiu i Shkodrës Imam Muhamed B. Sytari, mori pjesë në aktivitetet e kësaj shoqate me rastin e përkujtimit të ditës së flamurit.

Në mbrëmjen solemne me këtë rast, Myftiu mbajti referatin kushtuar kontributeve të hoxhallarëve dhe intelektualëve muslimanë për çështjen kombëtare.

"Me të vërtetë ti je toka më e mirë e All-llahut të Madhëruar dhe më e dashura tokë e All-llahut për mua dhe, sikur të mos më nxirrnin prej teje, unë nuk do të dilja!"

Ndër të tjera, theksoi se: "Është e pastudiuar si e sa duhet moria e madhe e shkrimeve, kushtimeve, vargjeve, himneve dhe përkujtimeve kushtuar Ditës së Pavarësisë të Shqipnisë sonë të shtrenjtë, si dhe kontributeve të vyera të hoxhallarëve dhe intelektualëve muslimanë për çështjen kombëtare në revistat islame dhe botimet e ndryshme, kryesisht ato të gjysmës së parë të shekullit 20.

E, kjo sasi e madhe tekstesh plot dobi, nëse vërteton diçka, faktin ndjenjën e sinqertë kombëtare tek elitat muslimane të vendit tone, një ndjesi e natyrshme e lindur me njeriun, që përkthehet më së miri në fjalët me të cilat Resull-llahu (a.s.) i drejtohej Mekës, vendlindjes së tij: "Me të vërtetë ti je toka më e mirë e All-llahut të Madhëruar dhe më e dashura tokë e All-llahut për mua dhe, sikur të mos më nxirrnin prej teje, unë nuk do të dilja!"

Gjatë qëndrimit në Londër, Myftiu zhvilloi edhe disa takime të dobishme me muslimanët shqiptarë atje, ku ligjëroi në disa takime të dobishme dhe bashkëbisedoi me të rinjtë shqiptarë, të interesuar për çështjet e ndryshme të fesë së tyre.

GJENEVË, MYFTIU REFEROI MBI LUFTËN E SISTEMIT KOMUNIST KUNDËR ISLAMIT DHE MUSLIMANËVE

Me ftesë të xhamisë "Dituria" në Gjenevë të Zvicrës, ditën e diel, më 2 dhjetor 2018, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari mori pjesë në aktivitetin e kësaj qendre islame shqiptare, me rastin e ditës së flamurit.

Aktiviteti u parapri nga përshëndetjet protokollare të bëra nga imami i xhamisë, Mr. Rijad Aliu, konsulli i Republikës së Kosovës në Gjenevë, z. Ramadan Avdiu dhe Kryetari i Bashkësisë Islame Shqiptare në Zvicër, Mr. Fehim Abazi.

Më pas, grupi i fëmijëve të xhamisë shfaqti një program me recitime e ilahi, që e zbukuruan tubimin.

U promovua edhe vepra e prof. dr. Nusret Pllana mbi gjenocidin serb në Kosovë, si dhe u shfaq një film me këtë rast.



Ndërkohë, Myftiu i Shkodrës u paraqiti me një referat, ku hodhi dritë mbi luftën e sistemit komunist kundër Islamit dhe muslimanëve, si dhe kontributin e hoxhallarëve për paralajmërimin e këtij rreziku për vendin dhe kombin.

MYFTIU VIZITOI QENDRËN ISLAME SHQIPTARE TË LOZANËS

Me ftesë të Kryetarit të Bashkësisë Islame Shqiptare në Zvicër, Mr. Fehim Abazi, ditën e diel, më 2 dhjetor 2018, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, vizitoi Qendrën Islame Shqiptare të Lozanës, në Zvicër.

Gjatë bashkëbisedimit me Kryetarin e B.I.Sh. në Zvicër, Myftiu theksoi se ka ardhur koha që muslimanët shqiptarë në

Zvicër të afrohen përherë e më shumë, duke dëshmuar veten të denjë për mbartjen e përgjegjësisë historike të njohjes së fesë islame me ligj në shtetin zviceran.

Nga ana e tij, Mr. Fehim ef. Abazi e informoi Myftiun për aktivitetet e larmishme të xhamive shqiptare në Zvicër, si dhe përpjekjet e dëshmuara për rritjen e këtij aktiviteti, duke

dëshmuar në vazhdimësi përhapjen e vlerave të Islamit dhe forcimin e vetëdijes islame.

Pas namazit të jacisë, Myftiu mbajti edhe një ligjëratë për të pranishmit, ku hodhi dritë mbi rëndësinë që ka ripërtëritja e besëlidhjes me Resulullahun (a.s.), për të ndjekur përherë udhëzimin e tij.



AKTIVITETI NDËRFETAR: "TË MBROJMË TOKËN, SHTËPINË TONË TË PËRBASHKËT"

Ditën e martë në mbrëmje, më 11 dhjetor 2018, tre komunitetet fetare të Shkodrës, organizuan një aktivitet të rëndësishëm me temë: "Të mbrojmë Tokën, shtëpinë tonë të përbashkët".

Në këtë aktivitet morën pjesë drejtuesit e komuniteteve fetare, të pushtetit lokal, policisë, universiteteve, prijës fetarë dhe shumë besimtarë e besimtare.

Në fillim dhanë mesazhet e tyre drejtuesit e komuniteteve fetare, Imzot Angelo Massafra, At Nikolla Petane dhe Imam Muhamed Sytari, mesazhin e të cilit e lexoi Lavdrim Hamja.

Mesazhet e tre drejtuesve fetarë ishin të rëndësishme dhe sensibilizuese për mbarë qytetarët, veçanërisht për besimtarët, të cilët duhet të japin shembullin e parë në ruajtjen dhe mbrojtjen e planetit, shtëpisë së përbashkët të mbarë njerëzimit.

Më pas referuan me kumtesat e tyre, teologu Arben Halluni, përgjegjës i arsimit dhe medias pranë Myftinisë Shkodër, At Fran Përlala, pjesëtar i



provincës Françeskane dhe rrëfyës, Laç dhe Miron Çako, drejtor i zyrës Katekistike i Kishës Ortodokse të Shqipërisë.

Duke u bazuar në Librat e Shenjtë, në Kur'an dhe Ungjill, por edhe duke u mbështetur në statistikat dhe faktet shkencore, të tre referuesit sollën në vëmendje amanetin e ruajtjes së tokës dhe dëmet e mëdha, që po shkaktohen nga vetë njeriu. Ata dhanë mesazhe të qarta,

se njerëzimi duhet të sensibilizohet dhe të jetë më i përgjegjshëm për rolin e tij si mëkëmbës i Zotit në tokë dhe njëkohësisht të mos bëjë çrregullime në tokë.

Aktivitete të tilla janë gjithmonë të mirëpritura dhe shprehin frymën e bashkëpunimit ndërfetar në dhënien e mesazheve me vlerë dhe humane, për paqen dhe të mirën e përbashkët të të gjithë njerëzimit.

MYFTIU: "KORRIGJIMI I TË KEQES NË SHOQËRI, DETYRIM I PËRHERSHËM ISLAM!"

Paraditën e së enjtes, më 13 dhjetor 2018, në xhaminë e fshatit Barbullush u organizua një aktivitet fetar, me rastin e përkujtimit të Lindjes së Begatë të Hz. Muhamedit (a.s.).

Në një atmosferë të ngrohtë vëllazërore, përtej temperaturave të ulëta të stinës, besimtarët e pranishëm përjetuan emocione që ndezin zemrën me përkujtimin e të Dërguarit (a.s.) dhe mesazhin e tij të përbotshtëm.

Në ligjëratën e tij, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, u përqendrua tek domosdoshmëria e ngritjes për rregullimin e të keqes që ka kapluar vendin!

Ai iu referua një ligjërimi të Hz. Muhamedit (a.s.), me të cilin iu drejtua sahabëve për t'i nxitur drejt korrigjimit të së keqes në jetë dhe mësimi të së mirës, që përhapet në shoqëri për ta ndryshuar zullumin dhe injorancën, korrupsionin dhe mashtrimin, afetarizmin dhe femohimin,



reklamimin e të keqes dhe përhapjen e saj si një gangrenë shkatërruese në shoqëri!

Myftiu, nuk la pa përmendur edhe përhapjen e të keqes në shoqërinë shqiptare dhe keqadministrimin e Shkodrës dhe mbarë vendit, ku propagandat e shturrura, që përhapin haramet dhe imoralitetin, sidomos në

lagjet muslimane të Shkodrës, janë një alarm që na fton të mos heshtim dhe t'i refuzojmë me tërë forcën e arsyes dhe legjitimitetit të saj!

Aktiviteti u pasua me këndimin e ilahive dhe pjesëve të përzgjedhura të "Mevludit" të Hafiz Ali Ulqinakut, kushtuar lindjes së Hz. Muhamedit (a.s.) dhe dashurisë për të.

Pas drekës së xhumasë, më 14 dhjetor 2018, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt, ambasadorin e Republikës së Turqisë në vendin tonë, Sh.T.Z. Murat Ahmet Yörük.

Gjatë takimit, Myftiu e uroi ambasadorin për vizitën që po zhvillon sot në Shkodër, sikurse shprehu mirënjohjen e tij të përsëritur për kontributet e shtetit turk për Shkodrën, sidomos me rastin e përmbytjes së fundit.

Myftiu vlerësoi se, marrëdhëniet e dy popujve tanë qëndrojnë mbi themele të forta, që sa vijjnë e forcohen, sidomos me rritjen e bashkëpunimeve të ndryshme, në fusha të shumta.

MYFTIU PRITI AMBASADORIN E TURQISË



Ambasadori i Turqisë, theksoi se, ditën e sotme ka planifikuar këtë vizitë protokollare në disa institucione të Shkodrës, si: Bashkia Shkodër, Rektorati i Universitetit "L. Gurakuqi", Myftinia, Medreseja "Haxhi Sheh Shamia", etj.

Ai tha se, kontributet turke për Shkodrën do të rriten, sidomos në gjetjen e një zgjidhjeje përfundimtare për problemin e përmbytjeve, por jo vetëm.

Në këtë vizitë, ambasadori turk shoqërohej edhe nga atasheu i ri për çështjet fetare, si dhe drejtori i Qendrës "Junus Emre" për Shkodrën.



Paraditën e së mërkurës, më 19 dhjetor 2018, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një vizitë në shtëpinë e imanit të nderuar, H. Fejzi Zaganjori.

Qëllimi i kësaj vizite ishte interesimi për gjendjen shëndetësore të imanit të xhamisë së Rusit, pas një luhatjeje të kaluar pak ditë më parë.

Myftiu falënderoi të nderuarin H. Fejzi Zaganjori për kontributin e tij dhënë për Myftininë Shkodër dhe ruajtjen e ekuilibrave dhe paqes sociale në kryeqendrën e Veriut të Shqipërisë, sidomos gjatë dy dekadave të fundit, si dhe shërbimet ndaj xhematit të xhamisë së Rusit dhe interesimin e vazhdueshëm për përhapjen e mesazheve të urta nëpërmjet ligjëtimeve të ndryshme gjatë kësaj periudhe.

H. Fejzi Zaganjori ka shërbyer për shumë kohë në krah të myftilerëve të periudhës së pas vitit 1990, në veçanti në kohën e myftilerëve të nderuar të

MYFTIU VIZITOI IMAMIN E XHAMISË SË RUSIT



Shkodrës, H. Faik Hoxha dhe Imam Ndriçim Sulejmani. Aktualisht është sekretar i Këshillit të Myftinisë Shkodër.

Ai ka një kontribut të paçmuar deri më sot, në përpjekjet për uljen e tensioneve dhe zgjidhjen e situatës së krijuar në vitin e vështirë 1997, ku së

bashku me drejtues të komuniteteve të tjera fetare, ka zhvilluar shumë tubime dhe lutje të përbashkëta për paqen dhe pajtimin kombëtar.

Akoma sot, ai vazhdon të shërbejë me përkushtim të madh, si imam, vaiz dhe hatib në xhaminë e Rusit.

MYFTIU TAKOI STUDENTËT SHQIPTARË NË MEDINE

Ditën e hënë, më 24 dhjetor 2018, gjatë qëndrimit në Medinen e Ndriçuar, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari zhvilloi një takim të përzemërt me studentët shqiptarë, që ndjekin studimet teologjike në Universitetin Islam të Medines, në Arabinë Saudite.

Me këtë rast, Myftiu mbajti edhe një ligjëratë, ku u përqendrua tek vlera e

madhe e pozitës së kërkuesit të dijes dhe domosdoshmërisë së pajisjes me durim dhe vullnet për mbërritjen tek dyert e suksesit.

Gjithashtu u ndal tek sfidat e ndryshme me të cilat përballlet shoqëria shqiptare dhe Thirrja Islame në vendin tonë, si dhe pozicionimin e thirrësve islamë në këtë çështje.

Myftiu tha se, përtej dijes që mund

të fitojmë në jetë, është urtësia ajo, që e vulos atë.

Ai dha edhe disa mendime e këshilla për studentët, duke uruar që të kenë suksese dhe të kthehen në vendlindje si fenerë udhëzimi dhe përhapës të dritës së besimit dhe vlerave të tij.

Më herët, Myftiu vizitoi edhe Universitetin Islam të Medines dhe bibliotekën qendrore të tij.



"TË MËSOJMË DHE TË ARGËTOHEMI" AKTIVITET ME FËMIJËT E KURSEVE FETARE TË XHAMISË VELINAJ DHE ALIMETAJ, ANA E MALIT.

Të mërkurën, më 26 dhjetor 2018, sektori i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër organizoi në xhaminë Velinaj aktivitetin e radhës me temë: "Të mësojmë dhe të argëtohem" me nxënësit e kësaj xhamie dhe nxënësit e kurseve fetare të xhamisë Muriqan.

Në këtë aktivitet mori pjesë dhe drejtuesi i arsimit, teologu Arben Halluni, i cili gjatë takimit me ta u mbajti një bisedë fetare, ku foli për vlerën që ka zhvillimi i mësim-besimit, për njohuritë kryesore të Islamit dhe për edukimin e brezave sipas frymës tradicionale islame, besimit dhe moralit që duhen të karakterizohen me përkushtimin ndaj Zotit (xh.sh), dashurinë dhe harmoninë më të gjithë njerëzit e krijesat e Tij.

Teologu Halluni falënderoi mësuesit e dy xhamive Velinaj dhe Alimetaj, Nebi Alia dhe Lulzim Beqiri për angazhimin dhe seriozitetin tyre në edukimin e brezave të ri si dhe për gjallërimin e xhamive me veprimtari të ndryshme islame.

Sipas programit të aktivitetit u zhvillua një konkurs fetar, koktejl, si dhe lojëra sportive.





Shejkh Muhamed El-Gazali
(1917 - 1996)

**"Imponimi në virtyt
nuk e bën njeriun të virtytshëm.
Ashtu siç imponimi në besim
nuk e bën njeriun besimtar.
Liria është baza e virtytit!"**

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org